



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQËRIA “UJËSJELLËS -KANALIZIME” BELSH Sh.A

Nr. ____ .Prot

Dt.22.06.2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: /ZEQIRI sh.p.k. Lagja Bishanak, Rruga Skenderbeu, Fier/

Procedura e prokurimit: **Kërkesë për propozim**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-58508-05-19-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje tubo me diameter me presjone te ndryshme dhe materiale hidraulike.”**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [26.05.2020] [30]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik **FAT Group** me Nr.Nipt **L43428401V** me oferte me vlere, **1880690** (nje milion e teteqind e tetedhete mije e gjashteqind e nentedhete) leke pa TVSH
2. Operatori Ekonomik **Baci-EL 2003 SH.P.K** Sh.p.k me Nr.Nipt **K42724211C** me oferte me vlere, **2385960** (dy milion e treqind e tetedhete e pese mije e nenteqind e gjashtedhete) leke pa TVSH
3. Operatori Ekonomik **Hest** me Nr.Nipt **L21527009H** me oferte me vlere, **2387250** (dy milion e treqind e tetedhete e shtate mije e dyqind e pesedhete) leke pa TVSH
4. Operatori Ekonomik **Zeqiri** me Nr.Nipt **J67902827A** me oferte me vlere, **1970000** (nje milion e nenteqind e shtatedhete mije) leke pa TVSH

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

I. Operatori Ekonomik FAT Group

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Mungon certifikata e konformitetit ne kundershtim me kerkesat per kualifikim
2. Mungon certifikata EN12201 ne kundershtim me kerkesat per kualifikim
3. OE nuk ka paraqitur Shtojca 5/1: Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës nje detyrim ky i percaktuar ne vendimin nr. 6 date 20.06.2019 te Agjencise se Prokurimit Publik. Nepermjet kesaj shtojce OE ka detyrimin qe te deklaroje **nën përgjegjësinë të plotë që:** Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. Lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. Nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.
4. OE ka paraqitur vertetim nr. 4158/1 Date 14.05.2020 ku percaktohet se operatori ekonomik nuk ka kontrate per energjine me OSHEE dhe per rjedhoje ka ne total 0 leke detyrime per faturat e energjise elektrike. Dokumenti i leshuar nga OSHEE ne kete rast nuk eshte I vlefshem per arsyet e meposhtme:
 - a. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektike lëshon vërtetimet e debisë, bazuar në deklaratimet vullnetare të subjekteve kërkues të kontratave të energjisë elektrike. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektike evidenton saktësinë e dokumentacionit

të paraqitur si më poshtë:

1. Tërësinë e kontratave të deklaruara nga subjekti (në rast se mund të ketë kontrata të tjera të padeklaruara).
2. Kontratat e furnizimit për objektet e tyre, duhet të jenë të tarifuara si private.
3. Kontratat e furnizimit duhet të jenë në emër të subjektit, përvec rasteve kur ato janë ambiente të marra me qira.

Në rast se subjekti ka paraqitur kontrata familiare, Operatori i kërkon këtij të fundit ndryshimin e tarifimit dhe pagesën me faturën e ardhshme të diferencës së cmimit bazuar në 10 legjislacionin në fuqi dhe kontratën e furnizimit me energji elektrike. Të gjithë operatorët që kërkojnë të pajisen me Vërtetimin e Debisë duhet të aplikojnë pranë Qendrave të KNK në të gjithë Shqipërinë dhe lëshimi do të jetë i mundur jo më vonë se pesë ditë pas kërkesës nga subjekti. Mosplotësimi i kriterëve të mësipërme do të rezultojë me moslëshimin e Vërtetimit të Debisë nga Drejtoria Qendrore ose Drejtoritë Rajonale.

Pra si është e mundur që është leshuar një vërtetim I tille në kushtet kur OE në fjale nuk plotëson asnjë nga kushtet e mësipërme ose me sakte nuk I deklaron ato.

- b. Në QKB OE deklaron se ka selinë në: Fier Fier FIER Lagjja Kongresi i Permetit, rruga Adriatiku, godine 3-kateshe, kati 1, zona kadastrale 8532, nr pasurie 6/147 pa informuar në këtë rast nëse ai furnizohet apo jo me energji në katin e parë të ndërtesës apo është në kushtet e shmangjes së lidhjes së kontratës apo është me qera dhe qeradhënesi paguan si biznes.

Përsa me lart duke qenë se Modeli zyrtar i lëshimit të Vërtetimit të Debisë në të gjitha rastet e statusit të Operatorëve përmbledh informacionin përkatës për rastet kur:

1. Konsumatori nuk rezulton debitor në Sistemin e Faturimit.
2. Konsumatori rezulton debitor.
3. Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur një aktmarrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste.
4. Konsumatori rezulton debitor por është në proces ankimi dhe ankesa është në trajtim nga strukturat e OSHEE-së.
5. Konsumatori rezulton debitor por vlera është e ankimuar në gjykatë.[...]

Vërtetimi I paraqitur nuk përmbush asnjë nga kushtet e mësipërme dhe për këtë arsye nuk është I vlefshëm

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **ZEQIRI, Lagja Bishanak, Rruga Skenderbeu, Fier** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **1970000** (në milion e nentëqind e shtatëdhjetë mijë) është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **SH.A Ujesjelles Kanalizime, Rruga Belsh-Kosove, Kilometri 5, Fshati Cepe, Ish-shkolla 9-vjecare** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar "**Baci-EL 2003 SH.P.K**", oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **2385960** (dy milion e treqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nentëqind e gjashtëdhjetë) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **12/06/2020**

Ankesa: **s'ka**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Ujesjellës – Kanalizime” Belsh Sh.A
Endri PEPA

